



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

KB Borea nga Peja në edicionin 2018/19 do të bëjë gara në Superligën e Kosovës

KB Borea nga Peja në edicionin 2018/19 do të bëjë gara në Superligën e Kosovës në basketboll. Një vendim të tillë e ka marr Bordi i Federatës së Basketbollit të Kosovës pasi që skuadra nga Peja i ka përmbushur kushtet e përcaktuara nga FBK për Wild Card.

#### Më poshtë mund ta gjeni vendimin e Bordi të FBK-së:

Në bazë të kompetencave të përcaktuara me Nenin 21, paragrafi 1, të Statutit të Federatës së Basketbollit të Kosovës, në ndërlidhje me nenin 5 të Rregullores për Sistematizim dhe Licencim dhe nenin 7.1 të Propozicioneve të Garave për edicionin garues 2018-2019, në bazë të procedurës së përcaktuar me nenin 6 të Rregullores së Punës së Bordit Ekzekutiv të Federatës së Basketbollit të Kosovës, pas konstatimit të plotësimit të kushteve të përcaktuara në vendimin e datës 13.08.2018 dhe në aktet normative të FBK-së, më 25.08.2018 me vota unanime ka miratuar këtë:

#### VENDIM

1. Miratohet aplikacioni i KB Borea Pejë në konkursin e WildCard për plotësimin e vendit vakant në Superligën e Kosovës në Basketboll për edicionin 2018-2019 dhe KB Borea bëhet anëtar i tetë i Superligës së Kosovës. KB Borea do të jetë bartëse e të gjitha të drejtave të ekipeve të Superligës së Kosovës si dhe e obligimeve të licencimit dhe regjistrimit për edicionin vijues.
2. Sekretarja e Përgjithshme e Federatës dhe Komesari i Garave udhëzohen t'i ndërmarrin të gjithë hapat e nevojshëm për implementimin e këtij Vendimi dhe realizimin e garave sipas kalendarit të miratuar paraprakisht.

Me respekt,  
Arben Fetahu  
Kryetar, FBK



Kosovo Basketball Federation, Lagjja "Arbëria", Bloku C3/(Faza 2), Rr. Radovan Zogoviq, Hyrja 7 10000 Prishtinë,  
Kosovë

ëëë.basketbolli.com, email: info@basketbolli.com, tel: +381 38 704 101; mob: +386 49 738 080



BAKER TILLY  
KOSOVO



automita



digi  
print

